



ÇMIMORE

J E T O J E K O H Ë N

KUSH JEMI NE

Grupi KOHA, grupi më i madh medial në tregun kosovar që në përbërje të saj ka gazetën e përditshme "Koha Ditore", televizionin kombëtar "KohaVision", shtypshkronjën "KOHA PRINT", televizionin kabllor "ARTA", shtëpinë botuese BOTIMET KOHA dhe Portalin KOHA.NET.

Historiku i shkurtër

Më 31 mars të vitit 1997 filloi botimi i gazetës "**KOHA DITORE**", e para e përditshme e pavarur në gjuhën shqipe në Kosovë. Që atëherë ajo ndërpreu botimin vetëm një muaj, pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, kur forcat policore e ushtarake serbe në shenjë hakmarrjeje detyruan mbylljen e saj, vranë rojën dhe dogjën shtypshkronjën (24-25 mars 1999).

Më 26 prill 1999, "**Koha Ditore**" rifilloi botimin në Maqedoni, ku u shpërndahej falas refugjatëve të dëbuar nga forcat serbe e që ishin vendosur nëpër kampe.

Gjithashtu, agjencia e lajmeve **ARTA**, ishte e para agjenci kosovare që nisi punën më 1 mars të vitit 1998 si ofruese shërbimi lajmesh nëpërmjet internetit në gjuhën shqipe e angleze. Nga maji i vitit 1998-s e deri më 24 mars të vitit 1999 në kuadër të Kompanisë Koha ka funksionuar edhe "**Radio KOHA**".

Shtylla e dytë e "Grupit KOHA" është "**KohaVisioni**", televizion kombëtar. Ka nisur emetimin e programit më 21 shtator 2001 dhe aktualisht emeton 24 orë program në rrjetin tokësor, satelitor dhe kabllor në Evropë.

BOTIMET KOHA është shtëpia botuese më serioze në Kosovë. Libri i parë i botuar ishte "Kosova, një histori e shkurtër" e Noel Malkolmit, më 1998. Deri tash janë botuar mbi 100 tituj veprash letrare të shkrimtarëve e autorëve të ndryshëm nga vendi dhe bota, si dhe tituj për fëmijë dhe tituj me përmbajtje historike.

Nga tetori i vitit 2009, KOHA ka lansuar portalin e vet **KOHA.NET** me moton: "Çdo minutë, një ecje me kohën", duke zëvendësuar dy faqet, ndër më të vizituarat, të Kohës Ditore dhe të KohaVisionit.

ARTA TV kanali i parë kosovar i lajmeve 24 orë në ditë.

Sot, Grupi KOHA është pronë e Flaka Surroi, e cila është edhe drejtoreshë menaxhuese e kompanisë.

Kompania numëron rreth 250 punëtorë dhe jo vetëm për këtë fakt, ajo është kompania më e madhe mediale e Kosovës që kultivon gazetari të pavarur dhe lirinë e shprehjes.



Marketing dhe shitje KOHA (KOHA Ditore;
KTV, Koha.net, ARTA dhe KOHA Print):
Tel: (+ 383 38) 248 014 dhe 248 015
e-mail:

ktvmarketing@koha.net
marketing@koha.net
marketing@kohaditore.com

Rr. Xhorxh Bush Nr. 41
Ish ndërtesa e Radio Prishtinës - Kati i 1-rë
KOHAVISION
Tel. 038 226-438

EC ME KOHËN



LAJMET E MBRËMJES

ÇDO MBRËMJE 19:00

Lajmet e Mbrëmjes është edicioni kryesor dhe më i besueshëm i lajmeve në Kosovë. Një grup gazetarësh e redaktorësh sjellin të gjitha lajmet nga politika deri te kultura nga secili skaj i Kosovës.



KOHA E LAJMEVE

E HËNË – E SHTUNË 10:00 / 12:00 / 15:00


Lajmet e fundit nga vendi dhe bota. Një grup gazetarësh e redaktorësh sjellin të gjitha lajmet në kohë reale nga secili skaj i Kosovës.



SPORTI NË KTV

E HËNË – E SHTUNË 19:45

Sporti në KTV është magazina ditore që sjell të gjitha zhvillimet kryesore në sport. Nga futbolli i Kosovës, futbollistët në botë dhe rezultatet e të gjitha sporteve vijnë të përmbledhura te ju.



GJITHOLOGËT

E MARTË – E ENJTE 20:05


Personazhet nëpërmjet të cilave regjisori Agon Myftari përfaqëson zërin e qytetarëve kosovarë, vijnë në transmetim pesë herë në javë në KTV. Sinani, Perpi, Astrriti, Avdyli, Blerimi e Noli tashmë janë yjet e rrjeteve sociale përmes batutave që ironizojnë me realitetin kosovar.



038

E PREMTE – 20:10


038 është emision javor që i dedikohet kryeqytetit. Tema në interes për prishtinasit, debat në studio dhe storie të cilat janë pasqyrë e problemeve dhe e sukseseve në Prishtinë.



JETA

E PREMTE 21:00

Jeta është magazinë televizive e cila shpalos histori suksesi përmes rrëfimeve të veçanta nga personazhe të veçanta. Përtej emisionit, në shumë raste ju shpie në destinacione të cilat vlen të vizitohen.



TEMPUS

E HËNË 20:10

Tempus është emision javor i cili përmes debatit në studio, në mënyrë të specializuar e trajton sundimin e ligjit. Emisioni është bashkëprodhim i Institutit të Kosovës për Drejtësi dhe KOHËS.



KONFRONT

E MARTË - E MËRKURË - E ENJTE 20:10

Konfront është emisioni qendror politik në KOHA VISION dhe mban primatin e emisionit me intervistat dhe debatet me tema ekskluzive në skenën televizive kosovare.



iINTERAKTIV

E HËNË – E PREMTE 22:30

Interaktiv sjell aktualitetin me bisedën për temën e ditës, sportin më origjinal, oopsat më të mirë dhe fotografitë tuaja në iKoha. Është magazina informative e pakonkurrencë në ekranet televizive në Kosovë.



FATI IM

E MARTË – E ENJTE 21:30

Seria e cila ka thyer rekorde shikueshmërie, sjell histori dramatike, mes luksit dhe intrigave. Lojë mes sukseseve dhe dështimeve në jetën profesionale e private të personazheve që nxisin debat përtej kornizave të produksionit televiziv.



CHATROOM

E HËNË – E PREMTE 07:00

Chatroom është emisioni me të cilin fillon dita në ekranet kosovare. Agnesa dhe Joni në 90 minuta sjellin informacion dhe argëtim, duke mos anashkaluar edhe komunikimin e drejtpërdrejtë me shikuesit për problematikat dhe preokupimet ditore.



SOT

E HËNË – E SHTUNË 08:45

SOT është emisioni i paradites në Kohavision. Format dinamik në transmetim direkt dhe me rubrika të përjavshme dhe ditore. Emisioni është shndërruar në zërin e qytetarëve përmes rubrikës “Hajt pak” dhe e mban primatin e programit më të shikuar të paradites në Kosovë.



TE LINDA

E HËNË – E PREMTE 08:30

Te Linda është kuzhina më e popullarizuar televizive në Kosovë. Receta me plot shije dhe delikatesë, të realizuara me përkushtim, janë mënyra e duhur për t'u njohur me shijet e reja dhe me ato tradicionale.



EXPRESS

E HËNË – E ENJTE 18:00

Express është emisioni televiziv me historinë më të gjatë në transmetim në televizionet kosovare. Magazina e pasdites është adresë për tema nga kultura, arti, showbizi dhe teknologjia.



DRIVE ME CRAZY

E HËNË – E PREMTE 16:00

Është emision i cili “frekuencën” e ka gjetur edhe në Kohavision. Në kohën kur rrugët vërshojnë nga trafiku, DMC sjell minuta relaksi me Arsimin, Mergitën dhe Fionën. Emisioni më argëtues i pasdites hap mikrofonin edhe për dëgjuesit dhe shikuesit për temën e ditës.



60 MINUTA

HËNË – E PREMTE 17:00

Lajmet aktuale, trajtimi i temave të ndryshme në terren dhe diskutimi me të ftuar në studio, përbëjnë pjesën qendrore të këtij emisioni. Kronika të veçanta si: Kalendar historik dhe Kronika për mjedisin ku qytetarët denoncojnë dëmin ekologjik nëpërmjet videove dhe fotografive, vijnë çdo ditë në 60 minuta.



FRIENDS

E HËNË – E ENJTE 14:35 dhe 00:35

Seria televizive më e shikuar ndonjëherë “Friends” sjell në ekranin e KTV-së jetën e 6 të rinjve të Nju Jorkut me të përbashkëtat dhe kontrastet mes tyre.



PFF

E SHTUNË 16:00

Programi fluturues i fëmijëve është emision edukativ dhe argëtues dedikuar fëmijëve. Përmes PFF-së, fëmijët në mënyrë kreative nxiten ta rrisin kureshtjen për botën që i rrethon.



FASHIONISTA

E PREMTE 18:00

Fashionista është stacioni ku takohen profesionistët e modës dhe adhuruesit e stilit. Format i vetëm televiziv mbi trendët e modës. Vendi ku imazhin dhe stilin e përjetoni nga një këndvështrim tjetër.



BETIMI PËR DREJTËSI

E SHTUNË 20:10


Betimi për drejtësi është emision tematik, i cili përmes hulumtimeve, analizave trajton sundimin e ligjit.



NËPËR FILM

E SHTUNË 16:30


Nëpër Film është hapësira e rezervuar për adhuruesit e filmit. Lajme nga shesh-xhirimet deri te tapeti i kuq vijnë të përmbledhura në 30 minutat e udhëtimit nëpër botën e kinematografisë.



RETRO ARTA

E DIEL 09:00

ARTA është kanali informativ që raporton në kohë reale ngjarjet e ditës. Por përmbledhja e zhvillimeve të javës në skenën politike të vendit, rajonit dhe botës vijnë në 30 minuta me emisionin Retro ARTA.



TOP KOHA MUSIC

E DIEL 16:00


Top Koha Music sjell muzikën moderne në ekranet tuaja. Top 100-shi përcaktohet me votën tuaj në koha.net. Emisioni njëherësh është platformë e promovimit të talenteve të reja në pop-skenën muzikore.



ÇA KA 3

DIEL 17:15

Është magazina javore në KTV, e cila u dedikohet adoleshentëve. Preokupimet e tyre, aktivitetet dhe gjithçka rreth adoleshentëve të Kosovës i gjeni çdo të diel në ekranin e KTV-së, prej orës 17:15.



PRO X E DIEL 17:40

Rrëfime të padëgjua më parë vijnë në vetën e parë, me personalitete nga sfera publike. Pro X është emisioni televiziv i cili transmetohet çdo të diel prej orës 17:40.



COSMO E DIEL 15:40

Cosmo është emision javor, i cili trajton tema të ndryshme në formatin e dokumentarit me një qasje përtej lajmit.



RRETH BOTËS E DIEL 19:40

Rreth botës ju shpie rrotull globit me përmbajtje informative, duke risjellë momentet të cilat shënojnë javën. Analiza me njohës të zhvillimeve ndërkombëtare sjellin përmbledhjen e ngjarjeve kryesore.




1 KAFE ME LABIN E DIEL 20:00

Një kafe me Labin është emisioni i cili i shoqëron kosovarët dhe jo vetëm, çdo të diel mbrëma. Me rekorde të shikueshmërisë, emisioni sjell freski dhe argëtim me personazhet më të njohura të estradës.



SPORTI TOTAL E DIEL 22:15

Sporti Total është emisioni qendror i sportit. Debate, analiza dhe detaje nga të gjitha sportet e Kosovës vijnë në një adresë, me tregime ekskluzive të personazheve sportive nga vendi dhe bota.



WILDLIFE E PREMTE 18:20

Dokumentarët e botës së egër në Kosovë dhe jo vetëm, në sytë e fotografit Arian Mavriqi vijnë në transmetim çdo të premte në ekranin e KTV-së. Pamje ekskluzive dhe unike e karakterizojnë përmbajtjen e vetme të llojit në ekranet televizive shqiptare.



BONE PËRHAJR

E SHTUNË 18:00

Emisioni i parë i patundshmërive në vend transmetohet çdo të shtunë në Kohavision. Çdo javë ju mund t'i kuptoni zgjedhjet e klientëve për shtëpitë e tyre të ardhshme të cilat prezantohen nga moderatorja Ariana Berisha.



TABU

E SHTUNË 22:30

Tabu është emisioni javor i cili drejtohet nga Nexha Gjema. Emisioni trajton tema në studio përmes bisedave të një formati të veçantë, duke përballur argumente të palëve të ndryshme.

KOHA E TRANSMETIMIT

PËRSHKRIM I PROGRAMIT

ÇMIMI EURO/SEC.

07:00-08:30	Chatroom	3.00 OPT
08:45-10:45	Programi i mëngjesit "SOT"	3.00 OPT
11:00-15:15	Blloqet e reklamave	4.00 OPT
15:15-16:30	Blloqet e reklamave	5.00 OPT
17:00-18:45	Para Lajmeve, "60 Minuta", Express	8.00 PT
18:45-19:00	Para Lajmeve të Mbrëmjes	10.00 PT
19:30-19:35	Brenda Lajmeve	10.00 PT
19:45-20:00	Pas Lajmeve, Para Sportit dhe Motit	8.00 PT
20:00-22:00	Blloqet e reklamave: Seriali turk, Konfront, 038	12.00 PT
22:30-23:15	Interaktiv	10.00 PT
23:30-24:00	Blloqet e reklamave	8.00 OPT
00:05-06:55	Programi pas mesnatës	3.00 OPT

KOHAVISION ofron sponsorizim të emisioneve më të shikuara, duke iu mundësuar brendeve dhe industrive të ndryshme të përfitojnë prezencë dhe reklamim në forma të ndryshme.

KOHAVISION ofron vendosje të produktit sipas kërkesës së klientit.

Çmime atraktive për secilin emision.

Investo duke u reklamuar në KOHAVISION!